



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.30/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli – kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi- anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së Znj. [REDACTED] nga Fushë Kosova, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokolli 01/3787-2025, të datës 10.12.2025, për Miratimin e Certifikimin e Listës Votuese për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZP.Anr.30/2025, e datës 22.12.2025, e parashtruar nga [REDACTED] nga Fushë Kosova kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokolli 01/3787-2025, të datës 10.12.2025, për Miratimin e Certifikimin e Listës Votuese për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 22.12.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë ZP.Anr.30/2025 nga [REDACTED] kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokolli 01/3787-2025, të datës 10.12.2025, për Miratimin e Certifikimin e Listës Votuese për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, për shkak se e njëjta kërkon të jetë e regjistruar në listën e votuesve brenda vendit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025. Dokumentet e paraqitura si provë: dokumentet personale të parashtruesit të ankesës - letërnjoftimi. Parashtruesja e ankesës pretendon se nuk gjindet në listë për votim, përse i mungon vota, kërkon të dijë pse vota e saj i mungon dhe kërkon nga PZAP-i, që ta pranojë këtë ankesë si të bazuar dhe të ligjshme dhe të lejohet që të votoj.

Në përgjigje në kërkesë KQZ ka theksuar se bazuar në nenin 8 paragrafi 1, të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili parasheh se: KQZ-ja mban Listën e votuesve dhe siguron që e njëjta bazohet në të dhënat e sakta, të përditësuara dhe më të fundit të Regjistrit Qendror Civil dhe e cila në mënyrë sistematike largon nga lista personat e vdekur dhe personat që kanë hequr dorë nga shtetësia. Kjo listë përmban: ekstraktin më të

vonë në dispozicion nga Regjistri Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si shtetas të Kosovës sipas ligjit për shtetësinë. Ndërsa paragrafi 2 i nenit 8 parashihet se: Lista e votuesve nga paragrafi 1 i këtij neni, përmban informatat personale të ofruara për secilin votues siç janë : emri, mbiemri, data e lindjes, adresa dhe Qendra e Votimit ku ai/ajo është caktuar për të votuar.

Gjithashtu, në nenin 3 të Rregullores Zgjedhore “Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës Votuese” parashihet procesi i krijimit të listës së votuesve.

Me tutje, KQZ me datën 10.12.2025, Nr.01/3787/2025, të vendimit ka certifikuar Listën Votuese për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 dhjetor 2025.

Afati për paraqitjen e ankesës ndaj vendimit për certifikimin e listës votuese ka qenë 48 orë, ndërsa pala ankuese është dashur që ankesën ta paraqesë brenda këtij afati. Gjithashtu, KQZ thekson se në ekstraktet e pranuar nga Agjencia e Regjistrimit Qendror Civil, të cilat i kanë pranuar me datat 21 nëntor 2025, 1 dhjetor 2025 dhe 5 dhjetor 2025, ku kishin kërkuar listën e të gjithë gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës që kanë mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeçare në ditën e zgjedhjeve dhe mbi 18 vjeç, nuk figuron emri i ankuesës [REDAKTUAR], me numër personal [REDAKTUAR].

- Ankesa është e pasafatshme

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesja e ankesës ka dorëzuar ankesën me datë 22.12.2025, ku ka pretenduar se nuk është përfshirë në listën e votuesve, ndërsa publikimi i listës është bërë me datë 10.12.2025 në bazë të vendimit për Miratimin e Certifikimit të Listës Votuese për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës.

Paneli ka vlerësuar se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 119, paragrafi 1 të LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe se ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 22.12.2025, për mospërfshirjen në listën votuese ku KQZ ka nxjerrë vendimin me nr. protokoli 01/3787-2025, të datës 10.12.2025, për Miratimin e Certifikimin e Listës Votuese për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor prej 48 orësh.

Njëherit, Paneli ka gjetur se ankesa e parashtruar nga znj. [REDAKTUAR] nga Fushë Kosova është e pasafatshme edhe duke u mbështetur në dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, ku parashihet që “Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara”.

Neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parasheh që: *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.”* PZAP-i vendosi që të hedhë ankesën e ankuesës pasi që ankesa është parashtruar si e pasafatshme.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 118 paragrafi 1 dhe 119 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, nenin 13, paragrafi 2, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZP.Anr.30/2025, datë 24.12.2025

Kryesuesi i Panelit

Kujtim Kasliu



Këshillë Juridike; kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të L.ZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.